

Mejreme (Abedin) Mullaabazi

(19.01.1944, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, katër fëmijë)

Ylfete dhe Mejreme Mullaabazi jetonin me familjet e veta në *Mëhallën Mullaabazi* [Rahovec/Orahovac]. Ishin të martuara për vëllezërit Qamilin dhe Nuredinin. Ditën e diel, më **20.07.1998**, policia serbe hyri në mëhallë duke i nxjerrë njerëzit jashtë dhe, më pas, duke iu vënë zjarrin shtëpive të tyre. Rreth orës 13:00, familjet e Qamilit dhe Nuredinit u larguan nga lagja e tyre dhe u nisën drejt bjeshkëve përmbi mëhallën e tyre [Rahovec/Orahovac]. Ylfetja dhe Mejremja, si edhe disa persona të moshuar, nuk mundnin të ecnin shpejt dhe rrjedhimisht mbeten prapa. Policët serbë shtënë mbi këtë grup. Plumbat i qëlluan Ylfeten dhe Mejremen në shpinë. Që të dyja u vranë në vend. U varrosën nga bijtë e tyre në fushën përmbi shtëpitë e familjes Mullaabazi. Pas përfundimit të luftës, më 2.07.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Ylfetes dhe Mejremes në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata J.M, FDH-32157; Proukoria Publike e Qarkut në Prizren, Kt. num. 83/99 (A. Kolašinac dhe të tjerë), aktakuza, 07.08.2000, FDH-8705.

Sabrije (Mehmet Bugari)**Mullaabazi**

(1917, shqiptare nga Rahoveci/Orahovac, amvise, katër fëmijë)

Hamdi (Shaip) Sharku

(24.06.1951, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, tregtar, tre fëmijë)

Mizahir (Abdurrahman)**Mullaabazi**

(16.06.1971, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac)

Sabrija e moshëthyer jetonte në bashkësi familjare me djalin Destanin, familjen e tij dhe familjen e djalit të dytë Abdurrahmanit, i cili ndërroi jetë para fillimit të luftës. Afro 300 metra larg shtëpisë së tyre, jetonte Hamdiu, vëllai i bashkëshortes së Destanit. Në datën 20.07.1998, rreth orës 10:00, forcat serbe hyrën në *Mëhallën Mullaabazi* dhe

filluan me vënien e zjarrit nëpër shtëpitë shqiptare në hyrje të mëhallës. Meqenëse shtëpia e Destanit ishte në hyrje të lagjes, të gjithë familjarët e tij, përpos Sabrijes dhe nipit të saj Mizahirit, u arratisën. Pas pak, erdhi Hamdiu për të parë nëse çdo gjë ishte në rregull. Që të tre u vranë më **20.07.1998**, rreth orës 19:30, në oborrin e shtëpisë së Destanit [Rahovec/Orahovac]. Policia serbe shkoi më 23.07.1998 që t'i merrte trupat e pajetë të të vrarëve. Me vete e morën të afërmin e viktimave Hilmiun, për t'ju dhënë emrat e viktimave. Më pas, i morën kufomat, i çuan në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac dhe i varrosën atje. Pas përfundimit të luftës, më 13.08.1999, ekspertët ndërkombëtarë të mjekësisë ligjore i zhvarrosën kufomat nga ky lokalitet dhe i prezantuan rrobat dhe gjësendet personale të të vrarëve. Falë rrobave të tyre, familjarët i njohën mbetjet mortore të Sabrijes, Mizahirit dhe Hamdiut. Po atë ditë, familjarët i kanë varrosur mbetjet mortore të viktimave në varrezat myslimane në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.N, FDH-852; deklarata N.N, FDH-879; deklarata D.M, FDH-32156; KMKMKRFJ, *Personat..*, FDH-10832.

Ibrahim (Mehmet) Sylka

(16.05.1914, shqiptar nga Rahoveci/Orahovac, bujk, një fëmijë)

Ditën e shtunë dhe atë të diel, më 18 dhe 19. 07.1998, familjarët e Ibrahimit i kaluan në shtëpinë e vet. Ditën e hënë, më **20.07.1998**, rreth orës 10:00, Ibrahimit me bashkëshorten Hajrijen u larguan nga shtëpia së bashku me të birin, nipërit dhe familjet e tyre, duke u strehuar në oborrin e Selamiut, djalit të shehut. Pas dhjetë minutash, Ibrahimit e ndërroi mendjen dhe u kthye në shtëpinë e vet [Rahovec/Orahovac]. Familjarët e tij u arratisën në të njëjtën ditë nga qyteti, duke mos pasur kurrfarë njohurish për fatin e mëtutjeshëm të Ibrahimit. Në datën 23.07.1998, trupin e pajetë të Ibrahimit, i cili ishte vrarë në kuzhinën e shtëpisë së vet, e zbuloi i vëllai Pajaziti. Kur u nis për ta varrosur vëllain, erdhën policët serbe dhe e morën